



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 198

Tiranë – E enjte, 27 tetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9766, datë 14.10.2016	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 21629
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 20 , datë 17.10.2016	Për shfuqizimin e udhëzimit nr. 12, datë 5.6.2012, “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”..... 21629
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 24, datë 7.10.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 13, datë 22.7.2016, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017”, të ndryshuar..... 21629
Urdhër i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 8136, datë 13.10.2016	Për miratimin e formularit të aplikimit dhe procedurave për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projektet për turizmin..... 21637
Urdhër i inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 469, datë 18.10.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 32/1, datë 15.7.2016, “Për miratimin e modelit të kartës së inspektorit”..... 21648
Vendim qarkullues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 26, datë 17.10.2016	Për miratimin e formatit standard të të dhënave për bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit..... 21648
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 4947/5, datë 17.10.2016	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore arë”, që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kV Laç–Skuraj”..... 21664
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 5549/4, datë 17.10.2016	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “ndërtim, tokë bujqësore arë, truall, kullotë”, që preken nga “Ndërtimi i Nënstacionit 110/20 kV Gjiri i Lalzit, Durrës”..... 21665
	Ndreqje gabimi..... 21666

**DEKRET**

Nr. 9766, datë 14.10.2016

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Arnold Lluk Prifti
2. Vojo Bozho Pelić (Shelçaj)
3. Lejla Sadulla Pelić (Boriçi)
4. Danica (Domenika Petro Camniq (Radusinović)
5. Gjyste Ndue Noll (Dukagjini)
6. Amelia Artan Baho
7. Elton Fadil Qinami
8. Dritan Novrus Xhaferaj
9. Altin Hans-Joachim Engel
10. Ardian Jorgji Sema
11. Bojana Janko Kontiq
12. Genci Piro Progni
13. Edmond Sami Mollaku
14. Inaza Fatmir Sinan
15. Auron Agron Alla
16. Olsi Xhemal Cano
17. Vladan (Artan) Gjorgje Krstović (Nikolla)
18. Darjan Zharko Sekulić
19. Amanda Radisha Krstović (Nikollaj)
20. Jovana Janko Kontiq

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

UDHËZIM

Nr. 20, datë 17.10.2016

**PËR SHFUQIZIMIN E UDHËZIMIT NR.
12, DATË 5.6.2012, “MBI PROCEDURAT E
KRYERJES SË VEPRIMTARISË SË
AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË
SEKTORIN PUBLIK”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të nenit 113, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe gurmës “a”, të nenit 23, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik,

UDHËZOJ:

1. Shfuqizimin e udhëzimit nr. 12, datë 5.6.2012, “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCIVE
Arben Ahmetaj**

UDHËZIM

Nr. 24, datë 7.10.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.7.2016,
“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE
TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË
PROGRAMET E STUDIMEVE ME
KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË
PROGRAMET E INTEGRUARA TË
STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2016–
2017”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,



UDHËZOJ:

I. Titulli i udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017”, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2016–2017”.

II. Pika 13 e kreut II të udhëzimit, ndryshon si më poshtë:

“13. Kandidatët të cilët nuk janë regjistruar brenda datës 16 tetor 2016 konform përcaktimeve të këtij udhëzimi, humbin të drejtën për t’u regjistruar në fazat e mëtejshme të parashikuara më poshtë në programet e studimit ku ata rezultojnë fitues gjatë raundit të dytë.

Pas mbylljes së regjistrimeve të raundit të dytë, në datat 17–18 tetor 2016, sekretaritetë mësimore të IAL-ve do të regjistrojnë *on-line* dhe me dokumentacion kandidatët. Regjistrimi do të bëhet duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të dytë, pas zbritjes së vijës së fituesit të fundit konform numrit të kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit. Kandidatët që rezultojnë fitues në këtë fazë dhe nuk regjistrohen me dokumentacion dhe *on-line* pranë sekretarisë mësimore përkatëse brenda afateve të sipërcituara humbin të drejtën e regjistrimit në fazat e mëpasme të konkurrimit për programet e studimit ku ata rezultojnë fitues në këtë fazë.

Në datat 19–20 tetor 2016, sekretaritetë mësimore të IAL-ve do të regjistrojnë *on-line* dhe me dokumentacion, konform numrit të kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit, kandidatët që rezultojnë fitues pas zbritjes së vijës së fituesit të fundit të fazës pararendëse për shkak të mosregjistrimit gjatë asaj faze, brenda datës 18 tetor 2016, të kandidatëve të tjerë pararendës fitues, duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të dytë.

Në kuotat e disponueshme për zbritjen e vizës për regjistrimet në një program të caktuar studimi, nga data 17 tetor 2016 deri më 20 tetor 2016, do të bëjnë pjesë të gjitha kuotat e mbetura

të paplotësuara, duke përfshirë kuotat e paplotësuara për kandidatët shqiptarë brenda vendit, shtetasit e huaj, kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, kandidatët të kategorive të veçanta, transferime dhe programe të dyta studimi, si dhe duke respektuar numrin total të kuotave nga IAL-ja për atë program studimi.

Kandidati nuk mund të regjistrohet në më shumë se një program studimi.”

III. Në fund të pikës 15 të kreut II të udhëzimit shtohet fjalia si më poshtë:

“Pas nënshkrimit në regjistër kryhet menjëherë regjistrimi i kandidatit *on-line* nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të tij, dhe në fund të procedurës përkatëse firmoset formulari i printuar nga sistemi nga aplikanti dhe sekretarja, në dy kopje, një prej të cilave i jepet aplikantit. Në përfundim të procesit ditor të regjistrimeve, çdo IAL dërgon të skanuar fletët e regjistrave të veçantë ku janë shënuar regjistrimet për atë ditë, të mbajtur sipas përcaktimeve të kësaj pike, në adresën elektronike rezana.vrapi@akp.gov.al, jo më vonë se ora 19:00 e çdo dite në të cilën janë kryer regjistrime.”

IV. Pas kreut IV/II të udhëzimit, shtohet kreu IV/III, si më poshtë:

“Kreu IV/III

Pranimet në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike nga data 7 tetor 2016 deri në datën 12 tetor 2016 dhe në IAL-të jopublike nga data 11 tetor 2016 deri në datën 17 tetor 2016.

2. Brenda datës 14 tetor 2016, IAL-të publike dhe brenda datës 18 tetor 2016, IAL-të private të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet web të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

3. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga



data 14 tetor 2016 deri në datën 19 tetor 2016, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së publike dhe nga data 18 tetor 2016 deri në datën 20.11.2016, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së jopublike.

4. IAL-ja shpall në vende të dukshme, publikon në faqen e saj web, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 20 tetor 2016 për IAL-të publike dhe 21 tetor 2016 për IAL-të private.

5. Njësitë kryesore të IAL-ve organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

6. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike paraprakisht.

7. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë “Bachelor”;

b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:

a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën “a”, të pikës 7, të këtij kreu, në një program të ciklit të parë “Bachelor”, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të njohur/të akredituar në momentin e transferimit;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor”, kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të njohur/të akredituar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.

9. Transferimi i studimeve mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtut cikël dhe lloj sipas kriterëve të vendosura dhe të shpallura publikisht paraprakisht nga IAL-ja.

10. IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.

11. Kanë të drejtë të aplikojnë për program të dytë studimi të gjithë kandidatët që:

a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë “Bachelor”, sipas përcaktimeve në germën “a”, të pikës 7, të këtij kreu, si dhe në një program studimi të ciklit të dytë;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe në një program studimi të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomave respektive pranë MAS-it.

12. Kandidati paraqitet personalisht dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara për ciklin përkatës të studimit konform kuadrit ligjor në fuqi, por që nuk disponojnë ende kartonin e diplomës në momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kanë përfunduar studimet konform përcaktimeve të pikës 4, të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS-i, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.

b) Diplomën e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të



njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA) ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.

Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

c) formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr. 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

d) fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

e) dy fotografi personale.

13. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe). Shtetasit e huaj, që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

b) Curriculum Vitae;

c) Deklaratën sipas shtojcës nr. 7 të këtij udhëzimi.

14. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh:

a) Kërkesën drejtuar institucionit të arsimit të lartë (IAL) për programin e studimit, në të cilin

kërkon të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit);

b) Plani i plotë i programit të studimit nga ku transferohet;

c) Vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin eventual të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera.

15. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi:

a) Fotokopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të dytë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara për ciklin përkatës të studimit konform kuadrit ligjor në fuqi, por që nuk disponojnë ende kartonin e diplomës në momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kanë përfunduar studimet konform përcaktimeve të pikës 4, të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Për diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të dorëzojë dhe vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS-i.

b) Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.

16. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) Kandidati me statusin e të verbrit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);

b) Kandidati me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social



Shtetëror ose kopje e noterizuar e vendimit të KMCAP-it;

c) Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

d) Kandidati rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

17. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

18. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

19. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. AKP-ja, pas verifikimit, e pajis me numër matrikullimi vetëm për programin e studimit ku është regjistruar më parë në kohë dhe i kërkon IAL-së tjetër ta çregjistrojë atë nga programi tjetër i studimit.

20. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecursisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

21. Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të

dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet web përkatëse, të plotësuara sipas tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në shtojcën nr. 8 të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.

22. Kandidatët fitues kryejnë regjistrimin e tyre përfundimtar në IAL.

23. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që transferojnë studimet:

Kandidati duhet të paraqesë në momentin e regjistrimit dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

i) emri, atësia, mbiemri;

ii) datëlindja;

iii) vendlindja;

iv) shtetësia;

v) numri i matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë;

vi) emërtimi i IAL-së dhe i programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e studimit;

vii) numri i matrikullimit, si dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit përkatës në IAL-në nga ku transferohet;

viii) cikli dhe forma e studimit;

ix) data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet;

x) data e ndërprerjes së studimeve;

24. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj web listën emërore të kandidatëve të regjistruar sipas programit të studimit dhe kategorive respektive.”

V. Pas shtojcës 6, të udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, të ndryshuar, shtohen shtojcat nr. 7 dhe 8 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

VI. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla



SHTOJCA nr. 7

Tiranë, më ____/____/2016

FORMULAR APLIKIMI

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____,
Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë:

- ☐ Master profesional
☐ Master i shkencave/Master i arteve të bukura

në _____, në IAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. Shtetas shqiptarë, brenda vendit për program të parë studimi

B. Shtetas shqiptarë, brenda vendit për program të dytë studimi

C. Shtetas shqiptarë, brenda vendit për transferim studimesh

D. Kandidatë shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

☐ Republika e Kosovës;

☐ Mal i Zi;

☐ Maqedoni;

☐ Preshevë;

☐ Bujanovc;

☐ Medvegjë;

E. Nga kategoritë e veçanta (të shënohet kategoria e veçantë së cilës i përket kandidati):

F. Shtetas i huaj

Gjuha amtare _____. Shtetësia _____

Emri i universitetit _____

1. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Sportit për pranimet në vitin akademik 2016–2017 në ciklin përkatës të studimit.

2. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shitesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

3. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, institucionin e arsimit të lartë dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

4. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017.



5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

emër atësi mbiemër
i kandidatit

Firma

emër mbiemër
i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma



SHTOJCË NR. 8

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji	IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik 2015-2016	Kreditet (ECTS) të e grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jo fitues
												Kriteri 1	Kriteri 2		Pikët totale	
1																
2																
3																
....																

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) të kryer më parë dhe lloji	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) ku aplikon për program të dytë dhe lloji	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jo fitues
											Kriteri 1	Kriteri 2		Pikët totale	
1															
2															
3															
....															

**URDHËR****Nr. 8136, datë 13.10.2016****PËR MIRATIMIN R FORMULARIT TË
APLIKIMIT DHE PROCEDURAVE PËR
PËRFITIMIN E MBËSHTETJES
FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET
PËR TURIZMIN**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, datë 27.7.2015, “Për turizmin”, pikave 8 dhe 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e thirrjes për projekt propozime në fushën e turizmit, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Miratimin e formularit të aplikimit për fonde për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projekte për turizmin sipas formularit bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Miratimin e udhëzuesit për thirrjen për projekt propozime, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Publikimin e procedurës për përfitimin e mbështetjes financiare në lidhje me projektet për turizmin, në faqen zyrtare të MZHETTS-së, në media, si dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi**



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Thirrje për Projekt Propozime në fushën e Turizmit

Një nga aspektet më kritike të turizmit në Shqipëri është sezoni turistik relativisht i shkurtër. Një turizëm i suksesshëm dhe kualitativ sigurisht varet nga të qenit në treg gjatë gjithë vitit. Natyrisht që ka përqëndrim të turistëve gjatë sezonit veror, por Shqipëria ka potencialin të njihet si një destinacion për tu vizituar, gjatë gjithë vitit. Qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje është të forcojë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e sektorit të turizmit në Shqipëri, duke inkurajuar zgjerimin e sezonit turistik nëpërmjet promovimit mediatik të produktit turistik vendas si dhe duke diversifikuar atë me modele inovative. Duke pasur parasysh këto objektiva kryesore, thirrja e dytë e këtij viti është e ndarë në dy tematika:

1. Promovimi i atraksioneve turistike, industrisë së mikpritjes nëpërmjet aktiviteteve mediatike dhe inovative

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- Rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë që ka turizmi për zhvillimin e vendit dhe përfitimet e mundshme për popullsinë lokale të rajoneve të ndryshme.
- 2. Zhvillimi dhe përmirësimi i produkteve turistike specifike, në përputhje me kërkesën gjithnjë në rritje për paketa turistike lokale, që ofrojnë përvoja të pazakonta me surpriza dhe ide stimuluese.

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- Zhvillimin e produktit turistik në mënyrë inovative drejt produkteve të interesit të veçantë me synim: argëtimin dhe shkëmbimin e eksperiencës.
- Zhvillimin e produktit turistik të kërkuar gjatë gjithë vitit duke kontribuar kështu në diversifikimin e grupeve të synuara (aktivitete të ndryshme me tematikë etnografinë, trashëgiminë kulturore, turizmin kulturor, turizmin e aventurës, gastronominë etj)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

UDHËZUESI PËR THIRRJEN PËR PROJEKT-PROPOZIME PËR VITIN 2016

Fondi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për projektet do të mbështesë propozime të paraqitura nga persona fizike dhe juridikë, vendas ose të huaj, privatë apo publikë që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre turizmin.

Ky fond shkon për projekte që zhvillohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Aktivitetet e propozuara duhet të përfundojnë brenda datës 31 Dhjetor 2016.

1. Kush mund të aplikojë?

a. Kriteret e pjesëmarrjes.

Subjektet pjesëmarrëse duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm lidhur me statusin e tyre juridik provuar me ekstraktin e regjistrimit dhe ekstraktin historik, si subjekt, NUIS-in si dhe dokumentet që vertetojnë se:

- 1) Nuk janë në proces falimentimi dhe se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;
- 2) Nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga Gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedure tjetër të ngjashme;
- 3) Nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale si person juridik, ortak apo aksioner i shoqërisë;
- 4) Kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
- 5) Kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

Te demostrojnë që janë në gjendje të financojnë 100 % të të gjitha kostove të projektit të propozuar përpara përfundimit të tij, provuar me kopje të certifikuara të balanceve të dy viteve të fundit, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licensuar auditimi dhe kopje të deklaratave të xhiros vjetore.



Nëse aplikuesi është i huaj ai duhet të vërtetojë që i plotëson të gjitha kërkesat e renditura me sipër. Nëse dokumentat e sipërper mendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë noteriale me shkrim nga ana e tij.

b. Përveç formularit të plotësuar, a duhet të paraqes dokumente të tjera?

Po. Nëse aplikoni si person fizik, lutemi të paraqitni një CV dhe një portofol të veprimtarisë tuaj. Nëse aplikoni si person juridik, lutemi të paraqitni një CV të subjektit, një portofol të veprimtarisë së tij të deritanishme.

V i n i r e ! I gjithë dokumentacioni duhet të jetë në tri kopje! Pas dorëzimit të dokumentacionit shoqërues të aplikimit nuk është e mundur të tërhiqet dokumentacioni nga arkiva e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

2. Metoda e aplikimit

Shkarkoni formularin për “Thirrje për propozime”, të cilin mund ta gjeni më poshtë në formatin Word ose PDF. Më pas plotësojeni atë.

- Shkarko formularin docx
- Shkarko formularin pdf

Formulari i plotësuar dërgohet në adresën e emailit Erifili.Monka@ekonomia.gov.al

Orari: 08-16.30.

Sigurohuni që në “subject line” të e-mailit të jetë shkruar qartësisht emri i aplikantit dhe titulli i projektit, ashtu siç janë shkruar edhe në formularin e aplikimit.

V i n i r e ! Përveç formularit të plotësuar, në këtë adresë nuk duhet të dërgoni asnjë material tjetër!

Formulari i plotësuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës referuar pikes **1. Kush mund të aplikojë?** duhet të dorëzohen në tre kopje pranë **Zyrës së Protokollit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në Adresën:**

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit" Tiranë, Albania.

Sipër zarfit të shkruhet qartësisht:

Drejtuar : Zyrës së Protokollit/Aplikim për projekte ; Emri i aplikantit; Titulli i projektit

Në raste specifike mund t’ju kërkohet informacion/dokumentacion shtesë. Nga ana tjetër, nuk do të marrim në konsideratë asnjë informacion/dokumentacion shtesë që nuk ju është kërkuar.

V i n i r e ! Në rastin kur aplikuesi është një subjekt, formulari duhet të mbajë firmën dhe vulën e subjektit.

b. Kur mund të aplikoj?

Thirrja për projekt propozime në fushën e turizmit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është hapur me datë 13/10//2016 dhe mbyllet me datë 13/11/2016 në përfundim të orarit zyrtar ora 16.30.



V i n i r e ! Nuk do të pranohet asnjë aplikim që vjen pas këtij orari!

c. Kur mund të fillojë projekti që kam propozuar dhe kur duhet të mbarojë?

Në përllogaritjen e kohëzgjatjes së projektit konsideroni procesin e plotë të aplikimit deri në firmosjen e kontratës sipas afateve të përcaktuara. Për këtë thirrje, projektet fituese nuk mund të fillojnë para datës 24/11/2016 dhe duhet të përfundojnë deri më 31 Dhjetor 2016.

d. Sa zgjat procesi i vlerësimit?

Procesi i vlerësimit zgjat 10 ditë.

e. Cila është shuma për të cilën mund të aplikoj?

Për realizimin e projekteve fituese, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të pranura e të miratuara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Projektet për të cilat do të kërkohet një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi në dispozicion për këtë thirrje për projekt-propozim është 22.000.000 Lekë.

Financimi nga Buxheti i shtetit nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkurues.

h. Ku mund të kërkoj ndihmë në lidhje me aplikimin tim?

Për informacione të përgjithshme, kontaktoni në:

E- mail: Erifli.Monka@ekonomia.gov.al

3. Për çfarë mund të aplikoj?

Financohen dhe mbështeten projekte zhvillimi, promovimi apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të turizmit

4. Si do të vlerësohen kërkesat për financim dhe/ose mbështetje për projekte pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes?

Çdo propozim kalon nëpër dy faza të vlerësimit:

- vlerësimi i personit fizik/juridik;
- vlerësimi i projekt-propozimit (formulari i propozimit).

Në procesin e vlerësimit të personit fizik/juridik që paraqet kërkesën do të merren parasysh: profili dhe reputacioni i personit fizik/juridik dhe kapaciteti zbatues/menaxhues i tij; theksojmë se kriteret e mëposhtme nuk duhet të shkurajojnë organizata të reja, të cilat mund të përmbushin kriteret e tjera;

- veprimtaria e deritanishme dëshmon se personit fizik/juridik ka në objekt të veprimtarisë së tij/saj turizmin dhe fushat e lidhura me te.
- misioni i organizatës dhe objektivat e veprimtarisë së saj të deritanishme përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;



- personit fizik/juridik ka përvoja të suksesshme me partnerë e donatorë të tjerë;
- personit fizik/juridik ka treguar qëndrueshmëri dhe është rritur me kalimin e viteve;
- personit fizik/juridik ka kontribuar në fushën ku operon me produkte të rëndësishme;
- personit fizik/juridik ka kapacitetin në terma të burimeve njerëzore dhe ekspertizën teknike për të zbatuar/menaxhuar projektin.

Në procesin e vlerësimit të projekt-propozimit (formulari) do të merren parasysh:

- projekti i propozuar ka në objekt të veprimtarisë së tij turizmin dhe fushat e lidhura me të
- objektivat e projektit të propozuar përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- problematika e identifikuar është aktuale dhe argumentimi i nevojës për projektin e propozuar është bindës;
- objektivat e projektit të propozuar përputhen me problematikën e identifikuar;
- origjinaliteti i projektit dhe cilësia e aktiviteteve të planifikuara;
- aktivitetet e planifikuara përputhen me objektivat e projektit dhe hapat e zbatimit të projektit janë të qarta dhe përfundojnë brenda datës 31 Dhjetor 2016
- shpërndarja e resurseve dhe bashkërendimi i punës midis partnerëve janë efikas;
- treguesit e përzgjedhur për matjen e rezultateve të aktiviteteve të planifikuara janë të përshtatshëm;
- përpilimi i kostove financiare: kostot janë reale (çmimet janë të bazuara në referenca që aplikanti mund t'i argumentojë) dhe të justifikueshme (raporti kosto/rezultat është i pranueshëm);
- niveli i bashkëpunimit me persona fizikë/juridikë të tjerë, si dhe bashkëfinancimi

Procesi i vlerësimit do të kryhet nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm i ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave posaçërisht për këtë qëllim.

d. Si duhet të veprojnë pasi kërkesa ime pranohet?

Nëse kërkesa juaj pranohet, ju do të njoftoheni për tu paraqitur pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; për të proceduar me lidhjen e kontratës. Me lidhjen e kontratës dhe fillimin e projektit do të fillojë gjithashtu edhe procesi i monitorimit nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Thirrje për Projekt Propozime në fushën e Turizmit

FORMULAR PËR APLIKIM PËR FONDE

Pjesa I: Informacione të përgjithshme

Titulli i projektit: [Type text]

Aplikanti (emri i personit fizik/juridik që aplikon/partneri 1): [Type text]

Statusi ligjor i organizatës që aplikon: [Type text]

Numri i regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Vendi i regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Data e regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

Pozita në organizatë: [Type text]

Tel: [Type text]

E-mail: [Type text]

Kohëzgjatja e projektit: nga data [Type text] deri në datën [Type text]

Vendi ose vendet e realizimit të projektit: [Type text]



Fusha dhe tema e projektit: [Type text]

Buxheti total: [Type text]

Fondet e kërkuara:

Pjesa II: Përshkrimi i projektit

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara (*maksimumi 10 rreshta*).

[Type text]

Objektivat e projektit (*maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv*):

1. [Type text]
2. [Type text]
3. [Type text]
4. [Type text]
5. [Type text]

Lloji i aktiviteteve sipas fushës, si dhe një përshkrim më i detajuar i aktiviteteve që janë planifikuar në çdo fushë (*maksimumi 5 rreshta për secilin aktivitet*):

1. [Type text]
2. [Type text]
3. [Type text]
4. [Type text]



5. [Type text]

A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (Maksimumi 5 rreshta):

[Type text]

A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve? (Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 4:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 5:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmblëdhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Qëndrueshmëria e projektit – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si personit fizik/juridik që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit?



Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Pjesa III: Partnerët (nëse ka)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 1 (Aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i subjektit tuaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Struktura. Përshkruani strukturën e subjektit duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Financimi. Si financohet subjekti juaj dhe cili ishte buxheti i tij për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 2

Emri i personit fizik/juridik: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

E-mail: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]



Pjesa IV: Buxheti

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruar dhe të mundshme?

Lloji i shpenzimit	≠ e njësisë	Çmimi	TOTAL	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-	MZHETTS
I. Shpenzimet direkte të projektit							
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
6.							
7.							
8.							
9.							
10.							
II. Shpenzimet administrative (deri në 15% nga totali i kërkuar)							
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
<i>Totali i shpenzimeve administrative:</i>							

TOTAL (edhe në %)¹:							
---	--	--	--	--	--	--	--

Vini re! Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e projektit.

¹ Ju lutemi të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë dhe MZHETTS-në dhe vetë aplikantin, qoftë ky individ apo organizatë), edhe si % e buxhetit total për projektin.

**URDHËR****Nr. 469, datë 18.10.2016****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHRIN NR. 32/1, DATË 15.7.2016,
“PËR MIRATIMIN E MODELIT TË
KARTËS SË INSPEKTORIT”**

Në zbatim të nenit 30, pika 4, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Në modelin e kartës së inspektorit, të miratuar me urdhrin nr. 32/1, datë 15.7.2016, të bëhen edhe këto shtesa e ndryshime:

Në pjesën e përparme të kartës së inspektorit, të ndryshohen:

- Stema e Republikës (në anën e majtë të kartës)
- REPUBLIKA E SHQIPËRISË (në mes të kartës)
- Logoja e Inspektoratit Shtetëror (në anën e djathtë të kartës)
- Në qendër fotoja e inspektorit:
(Dhe poshtë fotos do të shënohen):

KARTË INSPEKTORI

Emër, mbiemër:

Pozicioni:

Kodi:

Data e lëshimit:

Data e skadencës:

- Pjesa prapa kartës së inspektorit do të jetë me këtë përmbajtje:

Logoja e Inspektoratit Qendror (në pjesën e sipërme të kartës)

(Poshtë logos do të jetë e shënuar)

Inspektor i përgjithshëm

(Firma dhe vula)

Poshtë firmës dhe vulës do të shënohet ky paragraf:

Kjo kartë përdoret vetëm nga mbajtësi i saj. Në rast humbje ose dëmtimi të kartës, mbajtësi ka detyrimin ligjor ta deklarojë atë brenda 5 diteve pranë Inspektoratit Qendror.

Në pjesën e poshtme të kartës do të shënohet:
info@insq.gov.al

www.inspektoratiqendror.gov.al

2. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore/trupat e tjerë inspektues, për zbatimin e këtij urdhri.

Faqe | 21648

3. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror, www.inspektorati-qendror.gov.al dhe i njoftohet inspektorateve shtetërore/trupave inspektues.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari

VENDIM QARKULLUES**Nr. 26, datë 17.10.2016****PËR MIRATIMIN E FORMATIT
STANDARD TË TË DHËNAVE PËR
BANKAT DHE SHOQËRITË E KURSIM-
KREDITIT**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 3, pika 3, të nenit 26, të nenit 52, pika 2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 22, pika 1, të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, i ndryshuar, të nenit 25, pika 1, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, të nenit 8, pika 2, shkronja “d”, të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të nenit 10, pika 6, të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit,

VENDOSI:

1. Të miratojë formatin standard të skedarëve me të dhënat që bankat raportojnë në sistemin për raportim dhe kompensim, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të miratojë formatin standard të skedarëve me të dhënat që shoqëritë e kursim-kreditit raportojnë në sistemin për raportim dhe kompensim, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Autorizohet drejtori i përgjithshëm për dërgimin e këtij vendimi në banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Donald Duraj



ANEKS 1

Të dhënat dhe informacioni i mbajtur dhe i përpunuar në Banka që dërgohet në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

1. Flukset “Depozitë”

1.1 Kontrolli i të dhënave për flukset “Depozitë”

